

## Vendim nr. 308 datë 18.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marjana Semini, Anëtare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 18.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 42 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ALFRED TUSHA, përfaqësuar nga avokate Etleva Haka, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 4721, datë 27.12.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023- 5639, datë 26.09.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, pika 1, 42, 43, 44, 131 shkronja “f” dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, paragrafi 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi ka qenë i punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), ku së fundi ka ushtruar detyrën e përgjegjës të zyrës në sektorin e zbatimit (Task Forcë), në Drejtorinë e Hetimit Tatimor.

2. Me anë të memos nr. 19754, datë 17.07.2014 “Informacion për veprime abuzive të grupit Task Forcë” (memo nr. 19754/2014), drejtori i Hetimit Tatimor pranë DPT-së (eprori direkt), ka informuar drejtorin e përgjithshëm të Tatimeve se në datën 14.07.2014 në telefonin e tij celular i ka ardhur një mesazh që denonconte se në një subjekt tregtar në qytetin e Vlorës një specialist i tatimeve me emrin Fredi dhe persona të tjerë, gjatë kontrollit të ushtruar, kanë përfituar para nga subjekti i kontrolluar. Pas kësaj, eprori direkt ka shkuar te subjekti tregtar në fjalë dhe ka takuar persona të punësuar aty, si dhe bashkëshorten e pronarit, të cilët kanë dhënë informacion se punonjësit e tatimeve nuk i kishin treguar urdhrin e punës dhe nuk ishin prezantuar me emrat dhe shenjat dalluese. Më pas, ai ka verifikuar edhe kamerat e subjektit tregtar ku identifikohehin 4 inspektorët dhe dallohej se në dalje, kërkuesi, në cilësinë e përgjegjës të grupit, merrte diçka nga menaxheri i subjektit tregtar. Duke qenë se këto të dhëna krijojnë dyshime serioze për kryerje të veprime të kundërligjshme nga inspektorët, eprori direkt u ka kërkuar shpjegime atyre dhe, si përfundim, ka urdhëruar pezullimin nga detyra, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga drejtori i përgjithshëm i Tatimeve.

3. Komisioni i Disiplinës ka propozuar dhënien e masës disiplinore të zgjidhjes së menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës ndaj kërkuesit, mbi bazën e të cilit, drejtori i përgjithshëm i Tatimeve, me vendimin nr. 1301, datë 27.08.2014, ka vendosur zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës të kërkuesit.

4. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me vendimin, i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar dëmshpërblim në vlerën e 18 pagave mujore për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6635, datë 18.11.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke i njohur kërkuesit të drejtën për dëmshpërblim me 16 paga mujore. Ajo gjykatë ka konstatuar se në rastin e kërkuesit nuk është respektuar as procedura dhe as afati për zgjidhjen e kontratës dhe, në përfundim, ka çmuar se zgjidhja e kontratës së punës së kërkuesit ishte e menjëhershme dhe e pajustificuar, pasi në cilësinë e provës në gjykim u paraqit vetëm memoja nr. 19754/2014, për rrjedhojë shkeljet e pretenduara nga ish-punëdhënësi nuk u provuan. Kundër vendimit kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe DPT-ja.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4721, datë 27.12.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së

kërkuesit, me arsyetimin se ai vendim ishte rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe vlerësimit të gabuar të provave.

6. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5639, datë 26.09.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji.

7. Në datën 10.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara i janë cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1.1. *E drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, pasi gjykata e apelit e ka mbështetur vendimin e saj në prova që nuk kanë ekzistuar në dosje dhe ka zgjeruar interpretimin e fakteve pa kërkesë nga palët. Vendimi i saj është bazuar në një memo të hartuar nga një individ, i cili nuk ka qenë prezent gjatë kontrollit dhe që ka ngritur pretendime për prova të cilat nuk i ka parë askush dhe që nuk janë administruar në gjykim. Gjykata e apelit nuk i ka thirrur dëshmitarët për të konfirmuar vërtetësinë e faktit. Edhe pse kërkuesi i ka parashtruar këto shkelje të rënda procedurale në rekurs, Gjykata e Lartë është shprehur vetëm se rekursi nuk paraqet shkaqe ligjore, duke i mohuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë. Shkeljet procedurale janë evidentuar edhe nga mendimi i gjyqtarit në pakicë në Gjykatën e Lartë.

8.1.2. *Parimi i sigurisë juridike i lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi janë mbajtur standarde të ndryshme ndaj kërkuesit në krahasim me pjesëmarrësit e tjerë të grupit të inspektimit të përfshirë po në të njëjtën ngjarje. Gjykata e apelit në çështjen e anëtarit të katërt të grupit të inspektimit e ka gjetur të padrejtë lirimin e tij nga detyra për të njëjtin motivacion, për të njëjtën ngjarje, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm me rastin e kërkuesit. Kjo vërteton plotësisht se lirimi nga detyra i kërkuesit është bërë për motive politike, ashtu siç drejtori i Departamentit të Hetimit ka deklaruar më parë se do të liroheshin nga

detyra të gjithë ata që kishin marrë detyrën përpara zgjedhjeve të vitit 2013, që ishte edhe rasti i kërkuesit.

8.2. *E drejta e rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit në përputhje me ligjin*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është pasojë e procesit të parregullt dhe përmes tij kërkuesit i është shteruar e drejta për t'u dëmshtëpërbllyer për veprimet e padrejta të kryera nga punëdhënësi, i cili ka zgjidhur marrëdhëniet e punës pa shkak.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në vështrim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt ankimi, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

11. Kriteri paraprak i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës kërkon që individi t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në

substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me atë të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, Kolegji vëren se këto pretendime kërkuesi nuk i ka ngritur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por i ka parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, për këto pretendime Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

13. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, Kolegji konstaton se ai i është drejtuar Gjykatës pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe përmbajtje ose i ka lidhur ato me procesin në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka më mjete në dispozicion për kundërshtimin e tij përveç ankimit kushtetues individual.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin e datës 26.09.2023 të Gjykatës së Lartë dhe, sipas informacionit të kësaj të fundit, është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 02.07.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 10.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, me argumentin se vendimi i gjykatës së apelit nuk përmbushte standardet kushtetuese të arsytimit dhe se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk e ka riparuar këtë shkelje. Po kështu, ai ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u rehabilituar dhe zhdëmtuar, të parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, si pasojë e procesit të parregullt, përmes të cilit kërkuesit i është shteruar e drejta për t’u dëmshpërblyer për veprimet e padrejta të kryera nga punëdhënësi. Duke mbajtur në konsideratë se argumentet për procesin e rregullt ligjor lidhen në thelb me mënyrën e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe

se shkak, mbi të cilin bazohet pretendimi për cenimin e të drejtës për t'u zhdëmtuar lidhet me procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, Kolegji do ta analizojë çështjen në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

17. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit në arsytimin e vendimit të saj ka dalë jashtë kërkit të palës ankuese, e cila nuk ka pretenduar shkeljen e etikës profesionale të kërkuesit. Për më tepër ajo gjykatë e ka mbështetur vendimin vetëm në një memo deklarative të eprorit direkt të kërkuesit. Këto shkelje të rënda procedurale që pasjellin pavlefshmëri të vendimit gjyqësor nuk janë riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

18. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me vendimet e mospranimit të rekursit të marra nga Gjykata e Lartë, Gjykata ka theksuar se arsytimi i kufizuar i tyre nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsytimi i kufizuar është tregues i faktit se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 40, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejtat kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuarit, Kolegji do të verifikojë nëse vendimet e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë në rastin në shqyrtim janë të arsyetuara, pa gabime ligjore ose faktike të dukshme, pra nëse ka dyshime që përcaktimi i fakteve dhe interpretimi i ligjit në çështjen e kërkuarit të ketë qenë haptazi i paarsyeshëm.

22. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se gjykata e apelit në dhënien e vendimit të saj i është referuar memos nr. 19754/2014 të drejtorit të Hetimit Tatimor pranë DPT-së (*shih faqet 8-13 të vendimit të gjykatës së apelit*). Gjithashtu, ajo gjykatë ka administruar si prova në proces edhe procedurën në Komisionin Disiplinor të Tatimeve dhe vendimin nr. 1301, datë 27.08.2014 të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve për zgjidhjen e menjëhershme e kontratës së punës së kërkuarit, të cilat janë analizuar dhe vlerësuar së bashku dhe në harmoni të plotë me provat e tjera (*shih faqet 11-13 të vendimit të gjykatës së apelit*). Ajo gjykatë, pasi ka analizuar rrethanat e çështjes konkrete, në këndvështrim të kuadrit të ligjor të aplikueshëm në rastin e kërkuarit, duke vlerësuar se edhe pse provat nuk ishin të mjaftueshme për t'i atribuar kërkuarit kryerjen e ndonjë veprë penale, ato ishin më se të plota për të vërtetuar sjelljen tërësish jo etike dhe kundërshtim tërësor me rregullat e ushtrimit të kontrollit tatimor, të kryer me faj të rëndë, me pasojë të pashmangshme e të parikthyeshme, humbjen e plotë të besimit të punëdhënësit për kërkuarin, të tillë që nuk mund t'i kërkohej në asnjë rrethanë ish-punëdhënësit të vijojë më tej marrëdhëniet e punës (*shih faqen 11 dhe 13 të vendimit të gjykatës së apelit*). Rrjedhimisht, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se zgjidhja e kontratës së punës ka qenë në respektim të nenit 153 të Kodit të Punës për zgjidhjen e menjëhershme për arsye të justifikuar të kontratës së punës.

23. Për sa i përket arsyetimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, Kolegji vëren se ai kolegji, në shqyrtimin e çështjes konkrete, edhe pse ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuari nuk u referohen asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga ligji (*shih paragrafin 20 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*), e ka vlerësuar vendimin e gjykatës së apelit si të pacenueshëm dhe si një vendim që është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit. Sipas atij kolegji, nuk rezulton që gjykata e apelit të ketë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, të mos ketë garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ose të mos ketë sqaruar rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen (*shih paragrafin 23 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*), duke i dhënë kështu përgjigje edhe pretendimit të kërkuarit për mbështetjen e vendimit të gjykatës së apelit në një provë të vetme. Për pjesën e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave, ai kolegji është shprehur se del jashtë

juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës, ndërsa ka theksuar se është detyrë e rekursuesit të parashtojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit.

24. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, rezultojnë të jenë të arsyetuara, pa gabime ligjore ose faktike të dukshme, pra jo arbitrare, për rrjedhojë pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

25. Si përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.